



Republika e Kosovës / Republika Kosovo / Republic Of Kosovo



Komuna Rahovec / Opština Orahovac / Municipality Rahovec



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA



KOMUNA E RAHOVECIT - OPŠTINA ORAHOVAC
Drejtoria për Arsim
Odeljenje za Obrazovanje

-IV- Nr. i prot. 560 Më 28.10.2022
Br. prot. RAHOVEC - ORAHOVAC

Drejtoria për Arsim
Odeljenje za Obrazovanje
Department for Education

Raport tremujor i punës

Korrik, Gusht, Shtator (2022)

Gjatë tre muajve të tretë të vitit 2022 në kuadër të DKA-së u realizuan këto aktivitete:

Muaji Korrik

Pas shpalljes së rezultateve të Testit të Arritshmërisë për nxënësit e klasave të nënta, në datat 27,28 dhe 29 qershor u bë regjistrimi i nxënësve në klasat e 10-ta të Shkollave të Mesme të Larta. Kemi grumbulluar katalogjet e plotësuar të shkollave lidhur me kërkesat e planifikuara për tekste mësimore për vitin e ri shkollor 2022/2023 dhe i kemi dërguar në MASHT. Në objektet e shkollave "Isa Boletini" dhe "Bekim Sylka" kanë vazhduar punimet në ndërmarrjen e masave të efijencës së energjisë, përkatësisht në rregullimin e ngrohjes qendrore dhe në izolimin e themeleve. Në objektin e ri të çerdhes në Xërxë poashtu janë zhvilluar punime në vendosjen dhe instalimin e sanitarisë dhe instalimi i ndriçimit të brendshëm. Kemi nisur procedurën për projektin e drenazhimit të fushës sportive të jashtme në oborrin e SHML "12 MAJ" në Ratkoc. Kemi përgatitur dhe dërguar 5 kërkesa zyrtare drejtuar MASHTI-t. Ka përfunduar furnizimi me inventar i 2 objekteve të reja të shkollave dhe presim që gjatë kësaj jave të kryhet edhe furnizimi me inventar i 2 shkollave të tjera nga kompania që ka kontratë me ministrinë e arsimit. Kemi nisur procedurën për projektin e ndërtimit të objektit të SHFMU "Hamëz Thaçi" në Xërxë, e poashtu edhe për projektin e riparimit të nyjeve sanitare në Shfmu "Sapniqi" në Sapniq. Në bashkëpunim me grupin punues, kemi përgatitur një raport vlerësues për materialin mësimor për edukim mjedisor dhe riciklim të mbeturinave dhe atë raport vlerësues e kemi dërguar në organizatën JICA si pjesë e projektit të bashkëpunimit tonë, që do të zbatohet në 2 shkolla të komunës sonë. Janë bërë përgatitjet e duhura për pranimin dhe grumbullimin e teksteve mësimore, me të cilat do të furnizohemi së shpejti. Në seancën e rregullt të Kuvendit Komunal, kemi prezantuar raportin e punës së DKA-së për vitin mësimor 2021/2022.

Muaji Gusht

I kemi plotësuar me të dhëna formularët për Institucionet edukativo arsimore në kuadër të Planit Zhvillimor Komunal (PZHK). Kemi patur një takim në MASHTI lidhur me përgatitjet që duhet bërë për fillimin e vitit të ri shkollor, për tekstet mësimore dhe për afatin plotësues të regjistrimit të nxënësve në klasat e dhjeta. Janë bërë përgatitjet e duhura për pranimin dhe grumbullimin e teksteve mësimore, me të cilat pritej furnizimi. Grumbullimi i teksteve u planifikua të bëhej në Sallën e Edukatës Fizike të Shkollës Profesionale, e pastaj shpërndarja

nëpër shkolla. Kemi kontaktuar me zyrtarët e departamentit të Infrastrukturës dhe objekteve arsimore në MASHTI dhe kemi kërkuar informacion se kur do të fillojnë procedurat e prokurimit për 2 projektet, për projektin e ndërtimit të çerdhes në qytet dhe për projektin e ndërtimit të shkollës në Pastasel. Përkundër faktit që ne disa here kemi kërkuar fillimin e këtyre projekteve dhe i kemi dërguar me kohë dokumentet e nevojshme, siç janë kopja e planit të parcelave, pëlqimet urbanistike, certifikatat e pronësisë dhe të tjera, përgjigja që morëm nga zyrtarët e ministries ditën e enjte, ishte: "Do t'ju njoftojmë për fillimin e procedurave të prokurimit, pasi të shqyrtohet mundësia buxhetore nga MASHTI. Gjithashtu, nga zyrtarët e departamentit të infrastrukturës në MASHT, kërkuam pajisjen me inventar të 3 çerdheve të reja dhe na premtuan se furnizimi me inventar do të ndodhë së shpejti. U bë ekzekutimi i bursave për 169 studentët përfitues. Kemi siguruar vazhdimin e afatit të vlefshmërisë së Pëlqimit Elektroenergjetik nga KEDS për Çerdhen në Krushë të Madhe, pas kërkesës që kemi bërë. Kemi nisur procedurën e prokurimit për ndërtimin e aneksit të shkollës fillore " Katër Dëshmorët" në Ratkoc dhe gjithashtu kemi nisur procedurat për projektin e renovimeve në shkollën 'Bekim Sylka". Në objektet e shkollave "Isa Boletini" , "Bekim Sylka" dhe "12 Maji", kanë vazhduar punimet në ndërmarrjen e masave të efijencës së energjisë, por, këto punime për shkak të zhagjitjeve nga kompanitë punëkryese, nuk janë kryer në kohën e paraparë, në mënyrë që objektet të jenë të gatshme më 1 shtator. Në objektin e ri të shkollës "Heronjtë e Kosovës" përfundoi pajisja me inventarin e ri. Më 27 gusht, u organizua dhe u mbajt afati i dytë i Provimit të Maturës dhe këtij provimi iu nënshtruan 105 maturantë, të cilët nuk kaluan në afatin e qershorit. Në shkollën fillore "Rilindja" në Çifllak përfunduan punimet në ndërtimin e parkingut dhe rrethojës së oborrit të shkollës.

Muaji Shtator

Viti i ri shkollor nuk filloi më 1 shtator edhe kësaj radhe, për shkak të grevës së nisur nga SBASHK-u dhe BSPK-ja, që nga data 25 gusht 2022. Në objektin e shkollës "Isa Boletini" në kuadër të efijencës kanë vazhduar punime në riparimin dhe izolimin e kulmit, ndërsa në shkollën "Bekim Sylka" është punuar në vendosjen e radiatorëve të ngrohjes qendrore. Këto punime u zhvilluan shumë ngadalë. Punët kanë vazhduar edhe në Shfmu "Tre Dëshmorët" në Vrajakë-Bratotin, në të cilën është bërë montimi i dyerve të brendshme të objektit të shkollës. Më 13 shtator morëm pjesë në një sesion informues të organizuar nga GIZ - gjerman dhe Organizata RYCO lidhur me një projekt për të rinjtë e shkollave të mesme të larta, në të cilin këto shkolla do të aplikojnë. Si pasojë e reshjeve të mëdha të shiut, u përmyt nga uji shkolla në Sapniq, por objekti i shkollës dhe oborri i saj u pastruan nga kompania "Vetoni" dhe nga njësitë i zjarrfikësve i Drejtorisë për Mbrojtje dhe Shpëtim. Viti i ri shkollor filloi më 3 tetor, pas pezullimit të grevës nga SBASHK-u dhe BSPK-ja, e cila kishte filluar që nga data 25 gusht 2022. As gjatë javës së fundit të shtatorit nuk u pajisën me inventar shkollat dhe çerdhet nga operatori që ka kontratë me MASHTI-n.



Avni Morina
Avni Morina
Direktor i DKA-së